

PIKAT KRYESORE TË UDHËZIMIT TË RBA PËR SEKTORIN E LETRAVE ME VLERË

Hyrje dhe Objektivat

1. Qasja e udhëzimit me bazë riskun e FATF (RBA) për sektorin e Letrave me Vlerë përfshin një prezantim të përgjithshëm të RBA dhe ofron udhëzime specifike, si për pjesëmarrësit e tregut të Letrave me Vlerë, ashtu dhe për autoritetet e tyre mbikëqyrëse.
2. RBA është thelbësore për zbatimin efektiv të rekomandimeve të FATF. Kjo do të thotë që autoritet mbikëqyrëse, institucionet financiare dhe ndërmjetësit të identifikojnë, vlerësojnë dhe të kuptojnë pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit (ML/TF) rrezikun ndaj të cilit janë të ekspozuar dhe zbatimin e masave më të përshtatshme zbutëse. Kjo qasje i mundëson atyre të përqendrojnë burimet e tyre atje ku rreziqet janë më të larta.
3. **Udhëzimi synon të mbështesë hartimin dhe zbatimin e RBA, duke marrë parasysh vlerësimet kombëtare të rrezikut të ML/TF dhe kornizat ligjore dhe rregullatore të AML/CFT.** Ndonëse nuk është e detyrueshme, ai bazohet në përvojat e shteteve dhe sektorit privat dhe mund të ndihmojë në zbatimin efektiv të rekomandimeve të FATF-it.
4. Udhëzimi përfshin një prezantim të përgjithshëm të RBA dhe jep udhëzime specifike për shoqëri dhe ndërmjetës, si dhe për mbikëqyrësit e tyre. **Udhëzimi është zhvilluar në bashkëpunim me sektorin privat, për të siguruar që ajo të pasqyrojë ekspertizën dhe praktikat më të mira brenda fushës.**

Pikat kyçe

5. Udhëzimi përshkruan lloje të ndryshme të ofruesve të Letrave me Vlerë që mund të jenë të përfshirë në një transaksion të Letrave me Vlerë dhe modelet e tyre të biznesit. Ai gjithashtu përcakton karakteristikat kryesore të transaksioneve të Letrave me Vlerë që mund të krijojnë mundësi për shkelësit e ligjit, dhe masat që mund të vihen në vend për të adresuar dobësi të tilla.
6. **Udhëzimi nënvizon disa nga specifikat e sektorit të Letrave me Vlerë, të cilat duhet të merren parasysh gjatë zbatimit të RBA.** Veçanërisht sqaron:
 - a. Rolin dhe përgjegjësitë e ndërmjetësve që mund të ofrojnë shërbime në emër të ofruesve të Letrave me Vlerë për klientët e tyre, klientët e ndërmjetësve ose të dyjave. Ajo thekson se natyra e marrëdhënieve të biznesit midis ofruesit të

Letrave me Vlerë, ndërmjetësuesit dhe çdo konsumatori bazë do të ndikojë në mënyrën se si rreziqet ML/TF duhen menaxhuar;

- b. Kur përcaktohet lloji dhe shtrirja e CDD për t'u zbatuar, ofruesit e Letrave me Vlerë duhet të kuptojnë nëse klienti i tyre po vepron në emër të tij apo si një ndërmjetës në emër të klientëve të tij;
- c. Në përgjithësi nuk ka ndonjë pritshmëri ose kërkesë për një ofrues të Letrave me Vlerë për të aplikuar CDD në një klient të ndërmjetësit, i cili zëvendëson përgjegjësinë e ndërmjetësit. Megjithatë, kuptimi i bazës së një klienti të ndërmjetësuesit mund të jetë një element i dobishëm në përcaktimin e rrezikut, të lidhur me vetë ndërmjetësuesin. Niveli i mirëkuptimit duhet të përshtatet në nivelin e perceptuar të rrezikut të ndërmjetësit;
- d. Se ndonëse disa marrëdhënie biznesi në sektorin e Letrave me Vlerë mund të kenë karakteristika të ngjashme me marrëdhëniet bankare korrespondente ndërkufitare, Udhëzimi përmban një përshkrim se si kërkesat AML/CFT aplikohen për këto marrëdhënie.

7. Zhvillimi i vlerësimit të riskut të ML/TF është një pikënisje kyçe për aplikimin e RBA nga ofruesit e letrave me vlerë:

- a. Qëllimi kryesor i tij është të kuptojë dhe të ulë risqet e qenësishme të ML/TF dhe t'iu mundësojë ofruesve të letrave me vlerë, të menaxhojnë në mënyrë efektive risqet e mbetur;
- b. Duhet të jetë në përpjesëtim me natyrën, madhësinë dhe kompleksitetin e biznesit. Kjo do të thotë se një vlerësim i thjeshtë i riskut mund të mjaftojë për ofruesit e vegjël dhe në rastin kur ofruesit janë në nivel grupi, vlerësimi i riskut duhet të përfshijë shpërndarjen në grup të kuadrit të riskut;
- c. Duhet të rishikohet dhe përditësohet në mënyrë periodike.

8. Udhëzuesi jep shembuj të faktorëve gjeografik, të konsumatorit, të produktit/shërbimeve/ transaksioneve të riskut, për të cilat ofruesit e Letrave me Vlerë duhet të marrin parasysh vlerësimin e tyre të riskut.

9. Lidhur me masat zbutëse, udhëzuesi ilustron intensitetin e kontrolleve me vigjilencë të duhur ndaj klientit (CDD) që do të varet nga rreziqet e ML/TF. Masat e vigjilencës së shtuar do të zbatohen kur ka rreziqe më të larta dhe vigjilenca më e ulët mund të aplikohet në situata me rrezik të ulët. Gjithashtu jepen shembuj të masave të shtimit ose pakësimit të vigjilencës.

10. Udhëzimi thekson rëndësinë e kontrolleve të brendshme:

- a. "Kontrolli nga lart", përkatësisht përfshirja e drejtuesve të lartë dhe bordit në ngritjen e menaxhimit të rrezikut, mekanizmave të qeverisjes e kontrollit dhe mbështetjen e iniciativave AML/CFT;
- b. Ofruesit e Letrave me Vlerë, të cilat shpërndajnë produktet ose shërbimet e tyre përmes ndërmjetësve, siç janë ndërmjetësit e bursave ose platformat e fondeve, duhet t'i përfshijnë këto lidhje në proceset e brendshme të vlerësimit të AML/CFT;
- c. Procese adekuate të komunikimit të brendshëm, të cilat duhet të lidhin bordin me nëpunësit e njësive të pajtueshmërisë AML/CFT, komisionet përkatëse (p.sh. komisionet e riskut ose komisionet e pajtueshmërisë) njësia e teknologjisë së informacionit dhe secila prej zonave të biznesit;
- d. Rëndësia e testimit të pavarur të programit të AML/CFT, politikave dhe proceseve dhe cilësisë së menaxhimit të riskut.

11. Udhëzimi sqaron se **detyrimi për të raportuar transaksione të dyshimta nuk është i bazuar në "risk-base" por aplikohet pavarësisht sasisë së transaksioneve**. Ndërsa politikat dhe proceset që udhëheqin ofruesit e letrave me vlerë për të formuar një dyshim mund të aplikohen duke u bazuar në "sensitive-risk base".

Një ofrues i letrave me vlerë duhet të raportojë aktivitetin, sapo të formohet dyshimi i ML/TF;

12. Udhëzimi ofron **shembuj të përditësuar të treguesve, të aktivitetit të dyshimtë në lidhje me sektorët e Letrave me Vlerë, të cilat mund të kërkojnë paraqitjen e STR ose masave CDD** shtesë nga ofruesit e Letrave me Vlerë, ose hetime të mëtejshme ose monitorim të vazhdueshëm;

13. Për mbikëqyrjen e AML/CFT, udhëzimi ofron **shembuj praktikë të praktikave mbikëqyrëse të shteteve, për zbatimin e RBA në sektorin e Letrave me Vlerë**. Gjithashtu:

- a. Jep shembuj të faktorëve të rrezikut që mbikëqyrësit mund të marrin në konsideratë kur janë duke zhvilluar kuptimin dhe vlerësimin e tyre të sektorit të letrave me vlerë (p.sh. natyrën dhe kompleksitetin e produkteve dhe shërbimeve, madhësinë dhe modelet e biznesit, produktet financiare dhe informacioni i kontabilitetit, kanalet e shpërndarjes, profilet e konsumatorëve, vendndodhjen gjeografike dhe vendet e operimit), si dhe kontrollet në vend;
- b. Paraqet mënyrat për mbikëqyrësit për të zbutur rreziqet e ML/TF, bazuar në kërkesat që ata të ndajnë dhe t'i japin përparësi burimeve të zonave me riske më të lartë ML/TF;

- c. Thekson rëndësinë e qasjes në nivel grupi, duke përfshirë zhvillimin e vlerësimit në nivel grupi të risqeve ML/TF dhe shpërndarjen e informacionit përkatës midis mbikëqyrësve të përfshirë;
- d. Jep udhëzime se si të mbikëqyrë ofruesit e Letrave me Vlerë në kontekstin ndërkufitar.